



NJOFTIM PËR KOMISIONIN RREGULLTIVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Sipas Nenit 35.1 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për	Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik
Përmes	Ekrem Hajdari - Drejtor Menaxhues, AKP
Nga	Marjan Perlaska -Drejtor i Departamentit të Prokurimit
Lënda	Njoftim për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë
Titulli i aktivitetit të prokurimit	“Promovimi i Agjencisë nëpërmjet Radiove Lokale dhe Nacionale” Nr. prokurimit: 239-17-034-225 Vlera e parashikuar e kontratës për 12 muaj: 20,000.00€ Afati i kontratës është 12 muaj
Data	30/08/2017

Sipas nenit 35.2 të LPP, autoriteti kontraktues, pa ndonjë qëllim për të diskriminuar kundër apo në favor të ndonjë operatori ekonomik, ka përdorur Procedurën e Negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë. Arsyeja për marrjen e këtij vendimi:

Neni 35.2.1(i): arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike	<input checked="" type="checkbox"/>
Neni 35.2.1(ii): mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive	<input type="checkbox"/>
Neni 35.2.1(iii): emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues	<input type="checkbox"/>
Neni 35.2.2(i): dërgesa shtesë nga furnizuesi origjinal kur dërgesa të tilla shtesë janë zëvendësim i produkteve apo instalimeve paraprake	<input type="checkbox"/>
Neni 35.2.2(ii): blerjen e mallrave në një treg mallrash, vend-shkëmbim mallrash apo platformë ose sistem të ngjashëm tregtar.	<input type="checkbox"/>
Neni 35.2.3(i): një kontratë për shërbime që pason nga një konkurs i projektimit	<input type="checkbox"/>
Neni 35.2.3(ii): të drejte ekskluzive për të ofruar shërbime të tilla	<input type="checkbox"/>
Neni 35.2.4(i): zbatimi ose ekzekutimi i shërbimeve ose punëve shtesë që nuk ishin përfshirë as në konceptimin fillestar të një projekti të punëve të dhënë më parë dhe as të paraqitura në kontratën përkatëse të punëve që është përmbyllur më parë.	<input type="checkbox"/>

Neni 35.2.4(ii): punë apo shërbime të reja të përbëra nga përsëritja e punëve ose shërbimeve të ngjashme të besuara te operatori ekonomik të cili i ishte dhënë kontrata origjinale nga autoriteti kontraktues

SHPJEGIM

Në mënyrë që procesi i privatizimit/likuidimit të promovohet në mënyrë sa më të mirë të mundshme që të bëhet informimi i drejtë i të gjitha palëve të interesit, përfshirë investitorët potencial në përputhje me qëllimin për ngritje të vizibilitetit dhe imazhit pozitiv tek publiku i gjerë dhe palët e interesit, si dhe në pajtim me strategjinë për marketing të targetuar, Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënieve me Investitorë ka identifikuar mediumin e radiove si mjet efikas për informim, sidomos radiot lokale, përfshirë zonat e banuara me minoritete, ku radiot dhe TV nacionale në gjuhën shqipe nuk përdoren për informim. Shpalljet në radio do të përfshijnë njoftimin për të gjitha shpalljet e shitjeve të aseteve të ndërmarrjeve në likuidim si dhe të gjitha promovimet dhe njoftimet tjera relevante.

Me qëllim të lehtësimit të procedurave të brendshme si dhe të përkrahjes sa më të mirë teknike rreth monitorimit të shfaqjes së radio reklamave Njësia e Marketingut, kërkon që të lidhet kontratë njëvjeçare me Institutin e Medieve të Kosovës i cili mundëson vetëm një qendër kontakti për t'i arritur të gjithë akterët që na ofrojnë shërbime të tilla duke arritur Radiot Nacionale, radiot lokale dhe radiot në zonat e veçanta duke siguruar shërbime profesionale administrative dhe monitorim të transmetimeve gjatë gjithë kohës. Po ashtu pasi që Njësia e Marketingut tani bënë dhe përgatitjen e TV Reklamave me naracionin të cilat deri më tani nuk i ka bërë për të cilën gjë ka lindur nevoja e shërbimeve shtesë siç janë: përpunimi realizimi, produksioni, inçizimi, leximi, montazhimi dhe montazhimi me vijë melodike i TV reklamave dhe radio reklamave të cilat mund të ofrohen nga IMK.

Bazuar ne arsyetimet e dhëna, Departamenti i Prokurimit me kërkesën e Njesisë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë kërkon nga Drejtori Menaxhues si Zyrtar Kryesor Administrativ te aprovoj zbatimin e Procedurës se negociuar pa Publikimin e njoftimit për kontrate duke u bazuar ne nenin **35.2.1(i): arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike** që të nënshkruhet kontrata njëvjeçare me Institutin e Medieve të Kosovës për transmetim dhe realizim të reklamave në radio dhe përpunimin e TV Reklamave.

Vlera e parashikuar e kontratës: **20,000.00€**

Kohëzgjatja e kontratës do te jete **12 muaj** nga nënshkrimi i kontratës.

INFORMATA SHITESË:

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka të drejtë të kërkoj çdo informatë shtesë të nevojshme nga Autoriteti Kontraktues

Zyrtari i Prokurimit: Marjan Perlaska

Nënshkrimi: 

Informatat kontaktuese: Tel: 038 500 400 lokali. 1107

E-mail: marjan.perlaska@pak-ks.org